



BASHKIA SKRAPAR

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Studim projektim për "Ndërtim i godinës së re të palestrës"**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **72242000-3**

VLERA E FONDIT LIMIT: **1 435 863** (një milion e katërqind e tridhjetë e pesëmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë **pa TVSH**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Skrapar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Për pikën a.- në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26; për pikën b.-në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 83 “Sigurimi i ofertës”, pika 1 dhe 2, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, 2 dhe 3.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo kërkesë konsiderohet e plotësuar, nëse operatori ekonomik ofertues, është kualifikuar për kriteret e përgjithsme të kualifikimit, të përshkruara në pikën 1, sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të dorëzuar prej tij, në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe fiannciar

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, ofertuesi duhet të dorëzojë kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar, për vitet financiare 2023 dhe 2024, vlera minimale e të cilës të jetë sa 40% e vlerës së llogaritur të fondit limit që prokurohet, e shprehur në lekë **574,345 pa TVSH**.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe pika 1 dhe pika 2, gërma b) dhe pika 3, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabel, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”*

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e vitit 2024.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar apo ka ushtruar aktivitet sipas QKB-së.

Shënim : Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e maturuara për vitin 2024 **(në seksion të veçantë nga taksat dhe detyrimet tatimore në formularin e deklarimit nr.10).**

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Shlyerja

e detyrimeve vendore për operatorët ekonomik pjesëmarrës vërteton se ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik, në përputhje me kuadrin ligjor për taksat dhe tarifatat vendore

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme :

Për të provuar përvojën e mëparshme, ofertuesi duhet të dorëzojë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryer gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlera e të cilës të jetë të paktën sa 20% e vlerës së llogaritur të fondit limit që prokurohet, e shprehur në lekë **287,172 pa TVSH**. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike:
 - Vërtetim për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
 - Faturë tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat:
 - Faturë tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.3.1 gërma a), plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

ArgumentimiKërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe nenin 41 pika 3. dhe nenin 55, pika 4, gërma b) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2. Licenca profesionale

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, ofertuesi duhet të paraqesë:

Licencën profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, me kategoritë e mëposhtme:

Kat. 2	b-1	objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara
Kat. 2	c	Projektim interiere
Kat. 2	d	Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.
Kat. 3	a	Objekte civile – industrial – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate
Kat. 4	a	Projektim të instalimeve hidro-termosanitare
Kat. 4	b	Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.
Kat. 4	c	Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale
Kat. 4	f	Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
Kat. 4	j	Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.
Kat. 5	c	Ujësjiellës- kanalizime urbane – rurale
Kat. 8	a	Rilevime inxhinierike
Kat. 9	a	Studim/vlerësim gjeologjiko-inxhinierik i truallit për objekte civile deri në 5 kate.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit, që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe në Vendim nr. 759, datë 12.11.2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", i ndryshuar.

Licensat e mësipërme, janë kërkuar nga ana e Autoritetit kontraktor për shkak se lidhen ngushtë me objektin e prokurimit, dhe kërkesët e detyrës së projektimit (termat e referencës) si më poshtë:

Kat. 2	b-1	Objekti i prokurimit ka të bëjë me <i>objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara</i>
Kat. 2	c	Në detyrën e projektimit (termat e referencës), në pikën 5.3 Projekti i zbatimit, është kërkuar Projekti Arkitektonik përfshirë prerje dhe pamje për aredimin e brendësh.

- Kat. 2 d Në detyrën e projektimit (termat e referencës), në pikën II Qëllimi, përveç objektit është kërkuar **“sitemimi i terrenit, duke siguruar aksesin e nevojshëm, trotuare, gjelbërim, ndriçim dhe parkim”**.
- Kat. 3 a Objekti i palestrës së re përfshihet **“objekte civile prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate”**
- Kat. 4 a Në detyrën e projektimit (termat e referencës), në pikën 5.3 Projekti i zbatimit, është kërkuar **Projekti hidroteknik**
- Kat. 4 b Në detyrën e projektimit (termat e referencës), në pikën 5.3 Projekti i zbatimit, është kërkuar **Projekti i ngrohjes dhe ventilimit (në varësi të zgjidhjes së miratuar)**.
- Kat. 4 c Në detyrën e projektimit (termat e referencës), në pikën 5.3 Projekti i zbatimit, është kërkuar **Projekti elektrik**
- Kat. 4 f Në detyrën e projektimit (termat e referencës), në pikën 5.3 Projekti i zbatimit, është kërkuar **Projekti i mbrojtjes nga zjarri**
- Kat. 4 j Projektimi i mbrojtjes nga zjarri do duhet të përfshijë dhe **sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale**.
- Kat. 5 c Në detyrën e projektimit (termat e referencës), në pikën II Qëllimi, ndër të tjera është kërkuar **furnizimi me ujë, sistemi hidraulik, kanalizimet**
- Kat. 8 a Në detyrën e projektimit (termat e referencës), në pikën 5.3 Projekti i zbatimit, është kërkuar: *Planin e rilevimit në shkallën 1:1000.1:1500;1:2500 për ndërtesën; Azhornimin topografik i terrenit i pajisur me dimensione e kuota të gjendjes ekzistuese.; Hartimi i relievit topografik të zonës ku do të ndërhyet (koordinata lokale, koordinata absolute); Planvendosjen e objektit si dhe të objekteve të veçanta të përfshira në këtë projekt*
- Kat. 9 a Në detyrën e projektimit (termat e referencës), në pikën 5.3 Projekti i zbatimit, është kërkuar **Projekti gjeologjiko inxhinierik**.

2.3.3. Stafi dhe punonjësit

Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar pranë shoqërisë me kohë të plotë dhe të figurojnë në licencën e shoqërise për Studim – Projektim, Drejtuesit Teknikë të kërkuar më poshtë:

1	Arkitekt me eksperiencë profesionale mbi 7 vjet.	1 (një)
2	Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierisë së Ndërtimit (përfshijë profilin e infrastrukturës së transportit/Gjeoteknik)/ profili Inxhinier Mjedisi/ Inxhinier Mekanik profili Energjitikë/Termoteknik/Industri/Impiante me eskperiencë profesionale mbi 7 vjet	1 (një)

3	Individë me diplomë në profilet e Inxhinierisë së Ndërtimit me eskperiençë profesionale mbi 3 vjet	1 (një)
4	Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierisë Elektrike me eskperiençë profesionale mbi 3 vjet	1 (një)
5	Individë me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierisë së Ndërtimit (përfshijë profilet e infrastrukturës së transportit/Gjeoteknikë)/ profili Inxhinier për Ndërtim Qytetare Industriale me diplomë të përfshijë para vitit 1971/ Inxhinier Hidroteknik/ profili Inxhinier Mjedisor/ Inxhinier Mekanik profili Energjitikë/Termoteknik/Industri/Impiante/ profilet e inxhinierit Elektrik për automatizim apo industri me eskperiençë profesionale mbi 7 vjet	1 (një)
6	Individë me diplomë mastër ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet Hidroteknik të Inxhinierisë së ndërtimit me eskperiençë profesionale mbi 5 vjet	1 (një)
7	Individë me diplomë mastër ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Inxhinier Gjeodet/ Inxhinier Topograf/ Inxhinier Markshajder/ Inxhinier Gjeomatik me eskperiençë profesionale mbi 3 vjet	1 (një)
8	Individë me diplomë mastër ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet: Gjeologji inxhinierike/ Hidrogjeologji/ Gjeoteknikë	1 (një)

Shënim: Nëse 2 apo më shumë nga pikat e mësipërme, plotësohen nga një individ i vetëm, atëherë kriteri do të konsiderohet i plotësuar për këto 2 apo më shumë pikat përkatëse.

Për këtë duhet të parqitet

- një listë të drejtuesve teknikë të kërkuar më sipër,
- licencat profesionale për secilin
- listë pagesat e punonjësve të shoqërisë të siguruar për muajin Korrik 2025 (Formularët E-Sig 025/a.1), në të cilën duhet të figurojnë punonjësit e mësipërm.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, çdo anëtar i grupit duhet të kenë të punësuar drejtuesit teknik dhe stafin mbështetës inxhinier, sipas zërave të preventivit, që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4 gërma b), c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Inxhinierët drejtues teknik që janë kërkuar, përputhen me kategoritë e kërkuara të licencës së subjektit dhe argumentimin e bërë në pikën 2.3 gërma a), sipas kriterëve të përcaktuara në VKM-në nr.759 datë 12.11.2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e

kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", i ndryshuar, Lidhja 4 *Kushte dhe kritere specifike që kryesisht duhen plotësuar për të fituar kategoritë në fushat e Studimit dhe Projektimit.*

3. TË PËRGJITHSHME

Pavarësisht sa përcaktohet në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit”, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe të paraqitura nga ofertuesi në formularin përmbledhës të deklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE TERMAT E REFERENCËS

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Skrapar, ka hartuar Detyrën e Projektimit, e cila është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor dhe në të cilën janë trajtuar, të gjitha kërkesat në lidhje me realizimin e shërbimit të **Studim projektim për "Ndërtim i godinës së re të palestrës"**.

Janë përcaktuar:

- Objekti (përshkrimi i gjendjes egzistuese).
- Qëllimi i shërbimeve:
- Fazat e shërbimeve
- Afatet për realizimin e projektit
- Detyrat për Realizimin e Projektit
- Paraqitja e vizatimeve
- Afatet e realizimit të shërbimeve
- Vendi dhe mënyra e dorëzimit të shërbimeve

Detyra e Projektimit, do të jepet bashkëlidhur dokumenteve të tenderit.

Për pasojë, kërkesa e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 neni 2 “Dokumentimi i Procesit”, pika 2 gërma c), dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, konsiderohet e plotësuar.

KRITERET E VLERËSIMIT

Njësia e prokurimit, miraton Kriteret e përzgjedhjes së fituesit e cila do të jetë:

Oferta ekonomikisht më e favorshme, **Bazuar në Çmim**

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës, **brenda vlerës minimale dhe maksimale**, siç përcaktohet në VKM-së nr.354 datë 11.05.2016 "Manuali i tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim", për **Klasën “Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre”, Grupi Tarifor III, për projektimin e palestrës dhe Klasën “Strukturat në ambjentet e jashtme”, Grupi tarifor III, për projektimin e fushave sportive të hapura dhe sistemin e territorit.**

PËRFUNDIME

Me miratimin e kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, kriterëve të vlerësimit, si dhe specifikimeve teknike, njësia e Prokurimit miraton Dokumentet Standarte të Tenderit, për procedurën **“Procedurë e hapur e thjeshtuar”** me objekt prokurimi **Studim projektim për "Ndërtim i godinës së re të palestrës"**. Personi përgjegjës i prokurimit, pjesë e njësisë së prokurimit, të bëjë publikimin e procedurës në Sistemin e prokurimit elektronik, në faqen e APP-së.

NJËSIA E PROKURIMIT

Altin Lamçe

Ernest Ymeri

Florand Osmani